



Komiteti për shëndetësi dhe përkujdesje sociale

PROCESVERBAL

Mbledhja e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është mbajtur me datë **28.03.2024 (e enjte)** me fillim në ora **09:40**

Mbledhjen e parë e kryesoi Kryesuesja znj. **Vlora Vuçiterna Çmega**.

Për këtë mbledhje, u propozua ky rend dite;

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Përpilimi i planit të punës për vitin 2024;
3. Të ndryshme.

Kryesuesja – Atëherë fillimisht përshëndetje për të gjithë. Pas leximit të rendit të ditës, po e vendosim në votim si të tillë. Kush është “pro”?... Me vota unanime miratohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesja – A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “pro”?... Me shumicë unanime aprovohet pika e parë e rendit të ditës

2. Përpilimi i planit të punës për vitin 2024;

Kryesuesja: Atëherë, sa i përket përpilimit të planit të punës, bashkërisht kemi vendosur t'i zhvillojmë disa vizita gjatë vitit 2024: Vizitë në Qendrën për Punë Sociale – Rahovec, vizitë në QMF – Optrushë, vizitë AMF – Drenoc, vizitë në QMF – Fortesë dhe do të kemi takime të ndryshme me OJQ-të në Rahovec. Nëse dikush e ka ndonjë propozim tjetër?...

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesuese! Si vizitë propozoj që të shtohet edhe vizita në QKMF – Rahovec, të diskutohet rreth stafit dhe honorarit të punëtorëve shëndetësorë, duke përfshirë edhe zëvendësimet që i bëjnë brenda orarit të punës.

Kryesuesja – Faleminderit Lirigzon! Atëherë, kështu mendojmë t'i realizojmë vizitat tona në terren, pas mbledhjeve. Nëse dikush nuk ka ndonjë gjë tjetër, faleminderit për sot dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi;


Albion Krasniqi

Kryesuesja e mbledhjes;


Vlora Vuçiterna-Çmega

